

## PROCESI I SHQYRTIMIT TË ANKESËS

Faza e parë—Shqyrtimi paraprak i ankesës

**Zyra e Protokollit**  
-regjistron ankesën dhe kryen verifikimet paraprake



**Kryeinspektori**  
-cakton një inspektor dhe vlerëson e rishikon gjetjet, analizën dhe sugjerimet



**Inspektori**  
-analizon kushtet formale të ankesës dhe përgatit relacionin me rekomandimet fillestare, për t'ja përcjellë për miratim Kryeinspektorit



**Kryeinspektori**  
Urdhëron arkivimin e ankesës, kur ajo nuk plotëson kushtet formale, si dhe urdhëron njoftimin e ankesit me shkrim

Faza e dytë—Shqyrtimi përfundimtar i ankesës

**Kryeinspektori**  
-kur ankesa i plotëson kushtet formale, urdhëron verifikimin dhe njoftimin e ankesit -përcakton se cili gjyqtar do të verifikohet, për çfarë dhe nga cilët inspektorë



**Inspektorët**  
-bëjnë vlerësimin dhe hartojnë raportin me gjetjet përkatëse



**Kryeinspektori**  
-urdhëron përgatitjen e akteve përkatëse të cilat ja drejton (1) Ministrisë së Drejtësisë, ku propozohet masë disiplinore; ose (2) gjyqtarit përkatës, kur atij i tërhiqet vëmendja; ose (3) gjykatës/gjyqtarit, ku rekomandohet përmirësimi i punës, etj.



**Sektori Juridik**  
-Harton përgjigjen që i drejtohet ankesit

## KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Këshilli i Lartë i Drejtësisë  
Adresa: Bulevardi Zogu i I-rë  
Tiranë


Tel: +35542280804  
Faks: +35542259822  
email: kontakt@kld.al  
web: www.kld.al

Këshilli i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën, si dhe për kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit. Këshilli i ushtron funksionet kushtetuese të kontrollit dhe të rritjes në karrierë të gjyqtarëve nëpërmjet Inspektoratit të tij, që drejtohet nga Zëvendëskryetari. Një prej përgjegjësive kryesore të Inspektoratit është verifikimi i ankesave të qytetarëve.

Kjo fletëpalosje u botua me mbështetjen e



Si të drejtojmë një ankesë  
pranë Këshillit të Lartë  
të Drejtësisë



KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË  
www.kld.al



**Për çfarë faktesh mund të ankohemi pranë KLD-së**

Mund të ankohemi:

- \* Atëherë kur nuk është respektuar formalisht ligji, përfshirë rastet kur janë shkelur dispozitat urdhëruese proceduriale, apo nuk është bërë kërkesa për heqje dorë nga gjykimi, kur kjo është e detyrueshme sipas Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Procedurës Penale;
- \* Nuk është respektuar solemniteti gjatë gjykimit, përfshirë edhe vonesat në fillimin e seancës gjyqësore;
- \* Në lidhje me planifikimin dhe organizimin jo të duhur të punës;
- \* Për sjelljen e gjyqtarit gjatë apo jashtë gjykimit, gjë që nga ana tjetër ka ndikuar apo tregon dukshëm për zvarritje të procesit gjyqësor;
- \* Mund të ankohemi për mungesë të etikës profesionale në komunikim, apo shkelje të normave të sjelljes dhe etikës referuar Kodit të Etikës Gjyqësore;
- \* Për mungesë në motivim ligjor të vendimit gjyqësor;
- \* Kur nuk është zbatuar një vendim unifikues, si dhe vendime të tjera të Gjykatës së Lartë, kur sipas Kodeve të Procedurave këto vendime janë të detyrueshme;
- \* Për përdorim të shprehjeve të pahijshme dhe ofenduese në pjesën arsyetuese të vendimit gjyqësor;
- \* Për mënyra të vepruari me pasoja për palët në proces gjyqësor;
- \* Atëherë kur janë përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës, si dhe për shkak të parregullsive në procesin e deklarimit të pasurive;
- \* Për akte dhe sjellje të tjera që diskretitojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit.



**Për çfarë faktesh NUK mund të ankohemi pranë KLD-së?**

Nuk mund të ankohemi:

- \* Për shkaqe që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit në një rast konkret;
  - \* Për fakte të cilat zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor;
  - \* Mbi kërkesë-ankesa që lidhen me përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i një çështje konkrete;
  - \* Për sjellje të jetës private të gjyqtarit, përveç se kur ajo ka shkaktuar jehonë të gjerë në publik, lidhet me detyrën e tij dhe vlerësohet se është diskretituese për figurën e gjyqtarit;
  - \* Në lidhje me transferimin e çështjes nga një gjykatë në tjetrën;
- Për fakte që lidhen me veprimtarinë e organeve të tjera të drejtësisë: administratë gjyqësore, avokati, prokurori, zyrë përmbarimi, institucion të ekzekutimit të vendimeve penale, apo të institucioneve shtetërore palë ose jo në proces.



**Ndaj cilit subjekt mund të ankohemi?**

Ndaj çdo gjyqtari të shkallës së parë:

- \* gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, përfshirë edhe kryetarin e saj;
  - \* gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, përfshirë kryetarin e saj;
  - \* gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, përfshirë kryetarin e saj.
- Ndaj çdo gjyqtari të apelit:
- \* gjyqtar i Gjykatës së Apelit, përfshirë kryetarin e saj;
  - \* gjyqtar i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, përfshirë kryetarin e saj;
  - \* gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit, përfshirë kryetarin e saj.



**Ndaj cilit subjekt NUK mund të ankohemi?**

Nuk mund të ankohemi ndaj:

- \* gjyqtarit të Gjykatës së Lartë;
- \* gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese;
- \* punonjësi të administratës gjyqësore, përfshirë kancelarin e gjykatës;
- \* avokatit;
- \* prokurorit;
- \* përmbaruesit;
- \* noterit;
- \* juristit të një institucioni.

**Në ç'formë drejtohet ankesa?**

Ankesa përpilohet me shkrim dhe mund të dërgohet nëpërmjet shërbimit postar më të afërt në adresën:

**Inspektorati i KLD-së  
Këshilli i Lartë i Drejtësisë  
Bulevardi "Zogu I", Tiranë**

Ankesa mund të paraqitet nga ankuesi fizikisht në ambientet e Inspektoratit të KLD-së, ku plotësohet me shkrim formulari standard i ankesës pranë Zyrës së Protokollit të KLD-së. Ankesa mund të paraqitet edhe në rrugë elektronike në adresën:  
<http://www.kld.al/ankesa-online>

**Vini re: JU NJOFTOHENI ME SHKRIM GJITHNJË PËR ECURINË E ANKESËS**

**Me çfarë aktesh shoqërohet ankesa?**

Ankesa duhet të përmbajë:

- \* të dhënat e plota rreth identitetit të ankuesit: emër, mbiemër, adresa e saktë e vendbanimit, numrin e telefonit dhe adresë elektronike, sipas rastit;
- \* shkeljen apo rrethanat konkrete të pretenduara;
- \* kohën e ndodhjes së veprimit;
- \* gjykatën apo gjyqtarin konkret;
- \* dokumentet apo burimet provuese të fakteve apo rrethanave të pretenduara.